



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Ekstrakt i procesverbalit

të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,
mbajtur më 29.5.2025.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, Nora Kelmendi (VV), Mirsad Vitia (VV), Arbnora Berisha (VV), Gëzim Sveçla (VV), Jeta Rafuna (LDK), Milazim Vitija (LDK), Dhurata Jahaj - Retkoceri (LDK), Shegë Beqiri - Badivuku (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK) dhe Bahri Gashi (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, Valbona Makolli - drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Samir Shahini - drejtor në Drejtorinë e Arsimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, me këtë:

REND DITE:

1. Propozim-vendimi për Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025- 2026;
2. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
3. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;
4. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme MPB-së – Policisë së Kosovës;
5. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Këshillit Prokurorial të Kosovës;
6. Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve;
7. Propozim-vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
8. Propozim-vendimi për bartje të 45 normave nga cikli i mesëm i lartë në ciklin parafillor dhe fillor;
9. Propozim-vendim për ndërrim të destinimit nga banim individual në institucion arsimor privat;
10. Propozim-vendim për lënie në dëgjim publik të PRRH “Mati 1”, blloku A11;
11. Të ndryshme.

Valbona Makolli: - tha se ka dy propozime për pika të rendit të ditës, Propozim-vendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2024 në vitin 2025 dhe Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve

nga fondi rezervë. Ajo tha se Propozim-Vendimi për transferimin e mjeteve nga fondi rezervë duhet të aprovohet së pari në Kuvend, pastaj kur të aprovohet buxheti për vitin 2025 dhe bëhen plotësim- ndryshimet ta kemi edhe fondin rezervë. Drejtoresha tha se fondi rezervë nënkupton fondet e ngrira, të cilat duhet të kalojnë edhe njëherë përmes Kuvendit Komunal për arsye sipas tyre nuk janë plotësuar kriteret ose shënimet e nevojshme. Ajo tha se shembull për këtë e kemi ndërtimin e anekseve të shkollave me mësim tërëditor, e cila ka kaluar në fondin rezervë për arsye se më herët nuk ka qenë e definuar se cilat shkolla, ndërsa tash që janë të caktuara nga Drejtoria e Arsimit duhet të plotësohen kriteret përmes fondit rezervë. Makolli tha se në fondin rezervë është edhe marrëveshja në mes KfV-së, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Financave, dhe Komunës së Prishtinës për rrjetin e kanalimit, e nënshkruar në vitin 2022 nga Kryetari dhe nga ministrinë përkatëse, e cila ka mbetë për arsye se nuk kanë qenë të caktuara pjesët apo destinimi se ku do të kryhen intervenimet.

Gëzim Sveçla: - pyeti drejtoreshen se a duhet ne të përcaktojmë destinimin e këtyre mjeteve nga fondi rezervë?

Valbona Makolli: - tha si shembull shpronësimet, ku kemi një vendim që e kemi votuar në dhjetor, por Ministria e Financave e ka kthyer sepse duhet të definojmë se në cilën pjesë ose në cilën rrugë do të bëhet ky shpronësim. Ajo tha se ne si menaxhement si pjesën më emergjente për shpronësim, e kemi përcaktuar pjesën të rruga A.

Gëzim Sveçla: - theksoi se si projekt figuron edhe vendosja e kamerave të sigurisë, a ka pas komuna më herët kontratë për kamera të sigurisë dhe a nuk ka mjete të mjaftueshme apo ku është problemi?

Valbona Makolli: - tha, po ka një kontratë 3-vjeçare në mes Komunës së Prishtinës dhe Policisë së Kosovës, por për shkak të mosaprovimit të buxhetit të gjitha faturat janë në pritje për pagesa.

Gëzim Sveçla: - tha se a shtohet shuma e mjeteve nga grandit qeveritar dhe ku janë të destinuara ato mjete?

Valbona Makolli: - shpjegon se kjo shumë është ndarë për projekte të caktuara, disa prej të cilave kanë kriterë strikte që nuk janë përmbushur, për shkak të të cilave disa projekte nuk kanë mundur të realizohen, përfshirë edhe blerjen e kamionëve të "Pastrimit" që tashmë janë përfshirë në vendim. Ajo thekson se për vitin 2023 është bërë një vendim i Kuvendit për përdorimin e këtyre fondeve dhe se për herë të parë në dy vjet është pasur një rezervë për këtë vit, ndryshe nga vitet e kaluara. Makolli sqaron se për shkak të vonesave politike dhe zgjedhjeve, procedurat për miratimin e buxhetit dhe ndryshimeve në të janë ngadalësuar. Ajo kërkon falje për vonesat dhe thekson vështirësitë me shumë obligime në këtë periudhë.

Gëzim Sveçla: - tha se a mundemi me prit derisa të bëhet Qeveria?

Valbona Makolli: - shpjegon se për shkak të afateve kohore të shkurtuara, Vendimi duhet të miratohet në kohë, pasi ndryshimet në buxhet nuk mund të bëhen pa miratimin e Kuvendit Qendror, përkundër përfaqësimit të Ministrisë së Financave që trajton çështjet teknike.

Jeta Rafuna: - tha se pajtohem me propozimet për bartjen dhe transferimin e mjeteve, por thekson se për shkak të kërkesave ligjore, nuk do të votojnë menjëherë për këto pika dhe sugjeron që të diskutohen në seanca të rregullta për të shmangur konfliktet.

Valbona Makolli: - kërkon mirëkuptim nga anëtarët për organizimin e materialeve dhe dokumenteve që të mos humbet kohë gjatë seancave, duke propozuar dërgimin paraprak të dokumenteve për shqyrtim dhe shmangien e polemikave të panevojshme.

Kryesuesi: - tha se sot nuk mundemi as të shtojmë dhe as të largojmë pika nga rendi i ditës, vetëm t'i diskutojmë dhe të japim rekomandime për mbledhje të Kuvendit. Ai tha se i kërkoj edhe njëherë zyrës ligjore të kërkojë zyrtarisht opinion ligjor nga Ministria, se a kemi të drejtë të shtojmë apo largojmë pika në mbledhje të KPF-së. Kryesuesi tha se rekomandimet nuk kemi nevojë t'i votojmë, prandaj vazhdojmë me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës.

1. Propozim-vendimi për Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2025-2026, e diskutuar nga mbledhjet e kaluara.

2. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit për vitin 2025, e diskutuar në mbledhjet e kaluara.

3. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për Artin dhe Kulturën 2026-2031, e diskutuar në mbledhjet e kaluara.

4. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paligjshme të Ministrisë Punëve Mbrëmshme të Policisë së Kosovës, e diskutuar në mbledhjet e kaluara.

5. Propozim -vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Këshillit Prokurorial të Kosovës, e diskutuar në mbledhjet e kaluara.

Nora Kelmendi: - tha se për këtë pikë, në mbledhjen e kaluar të KPF-së, kam kërkuar sqarime nga drejtori të cilat nuk i kam marrë.

6. Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve, të diskutojmë në Kuvend.

7. Propozim-vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit p parauniversitar, e diskutuar në mbledhjet e kaluar.

8. Propozim-vendimi për bartjen e 45 normave nga cikli i mesëm i lartë në ciklin parafillor dhe fillor.

Samir Shahini: - tha se unë për këtë pikë kam përgatitur edhe një sqarim të cilin ju kam përcjell, për situatën me vendet e punës dhe aryen pse kërkojmë transferimin e normave nga shkollimi i mesëm në atë fillor dhe parafillor. Drejtori tha se në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, kemi konstatuar 53 norma të lira, të cilat vijnë si rezultat i demografisë si rezultat i lëvizjeve nga sektori

publik, shpeshherë në sektor privat dhe të ngjashme. Tutje tha se kemi 53 vende të lira dhe këtu kërkojmë që të kalojmë në votim bartjen e 45 prej tyre, sepse duhet të parashohim edhe një fleksibilitet edhe në shkollimin e mesëm për çdo eventualitet që mund të vijë në një profil të ri ose ndonjë ndryshim eventual, sikur e kemi një nga shkollat "Gjin Gazulli", që është një profil i ri që është akredituar dhe fillon nga shtatori. Drejtori tha se në arsimin parafillor kemi llogaritur 18 vende, përveç atyre që marrim nga Ministria e Arsimit me grande specifike për arsim, ndërsa 27 tjera i kemi llogaritur për shkollimin fillor, të cilat besoj se janë të nevojshme për mbulimin e orëve për mësim tërëditor.

Gëzim Sveçla: - tha se 18 norma nga këto 45 janë të arsyetuara për shkak të rritjes së kapaciteteve edhe për shkak të çerdhes në Dardani, po asnjë arsyetim për nivelin fillor dhe të mesëm. Pse po kërkojnë këto norma shtesë?

Samir Shahini: - tha se një pjesë e tyre janë të caktuar, por ende nuk i kemi numrat e saktë, sepse jemi në proces të analizimit të nevojave për përmbushjen e mësimi tërëditor, sidomos në këtë fazë që po i shtojmë edhe 6 shkolla të reja. Ai tha se jemi duke punuar si drejtori, me drejtorë të shkollave dhe Institutin Pedagogjik të Kosovës të riorganizojmë komplet formën e orëve të pasdites, e cila është diçka ende e panjohur për ne. Shahini theksoi se pjesa tjetër është paraparë për shërbimet shtesë të psikologëve dhe perdagogëve në shkolla, që fatkeqësisht në këtë afat të konkursit nuk kemi pasur asnjë, asnjë vend të lirë dhe pas miratimit të vendimit në Kuvend, ne si drejtori do ta përgatisim një analizë me numra të saktë të ndarjes dhe do t'ju përcjellim në Kuvend.

Leutrim Retkoceri: - tha se duke u bazuar nga preambula e vendimit po shihet se është e njëjtë me atë të cilën është aplikuar në shumicën e vendimeve, prandaj kërkoj nga drejtori të di se a është konsultuar me zyrën ligjore dhe a është përgjegjësi e asamblesë komunale me bë bartjen e këtyre normave. Retkoeci pyeti drejtorin se a janë shfrytëzuar normat nga granti qeveritar për marrjen e stafit dhe a ju lejohet, nëse po sa është numri i tyre?

Samir Shahini: - tha sa i përket vendimit, ne si Drejtori e Arsimit e kemi përgatitur vetëm pjesën e arsytimit të cilën e kemi përcjelluar pastaj në zyrën ligjore, ku kemi kërkuar përgatitjen e Propozim-vendimit të cilin ju është përcjell nga zyra e Kuvendit. Shahini theksoi se arsyeja e sjelljes të këtij propozimi është sepse kemi kërkuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit që të bëjmë drejtëpërdrejtë me ta këtë lëvizje, por ata janë përgjigjur se duhet që të kalojë përmes Kuvendit për arsye se është lëvizje nga një nivel në tjetrin. Drejtori tha se të gjitha këto norma janë të akumuluar edhe nga ana e pensionimit ose shuarjes së profileve të caktuara në shkollimin e mesëm, pra është një riorganizim shumë i natyrshëm që nuk përbën asnjë rrezik për vendet e punës të personave që veç janë të angazhuar në këto pesëdhjetë e tri norma të lira. Ai theksoi se përveç sqarimit të dhënë për kopshtin "Xixëllonjat", tash presim edhe kopshtin e ri që do të finalizohet në Dardani, ku janë kërkuar punëtorë shtesë dhe në pritje të disa objekteve tjera edhe të shkollave fillore, që përbën arsyetimin kryesor përtej mësimi tërëditor. Tutje tha për grantin specifik për arsim, se nuk është i njëjtë me numrin e punëtorëve të administratës, pra numri i punëtorëve të administratës së kryeqytetit, përcaktohet me total të numrit banorëve, derisa granti specifik për arsim e rregullon numrin e mësimdhënësve edhe të punëtorëve, bashkpunëtorëve profesionalë, shërbimeve në shkollë, në bazë të numrit të nxënësve.

Gëzim Sveçla: - pyeti drejtorin a mundeni të na informoni më shumë se çfarë ka ndodhur me ndërrimin e drejtorëve në shkollën fillore "Dadania"?

Samir Shahini: - tha se në shkollën "Dardania" kemi përsur një procedurë të hetimit nga Komisioni disiplinor në kuadër të Komunës së Prishtinës, e iniciuar pak para ardhjes time në drejtori dhe ajo çështje ka marrë epilog. Është një raport i cili është hartuar nga Komisioni disiplinor ju e dini se funksionon i pavarur nga ana e Drejtorisë së Arsimit dhe ana e mbikqyrjes time dhe në bazë të gjeturave të këtij raporti është vendos për drejtorin z.Besim Gashi që të ulet në detyrë. Pastaj kemi pas edhe një ankesë nga ana e z. Gashit dhe në shkallë të dytë prapë është kthyer në refuzim të ankesës për shkak të volumit të dëshmive të komisionit dhe aktualisht kemi një ushtrus detyrë të drejtorit, që është fjala për zëvendësdrejtorin e mëhershëm Arben Fejza dhe Afrim Gashin, ushtrues detyrë i zëvendësdrejtorit.

Gëzim Sveçla: - pyeti drejtorin se cila është natyra e shkeljes që ka zotëruar?

Samir Shahini: - tha sa i përket natyrës së shkeljes nuk jam përgjegjës dhe kompetent për të sjellur përgjigjen, prandaj duhet të kërkon nga Komisioni disiplinor i cili është komision i pavarur.

Gëzim Sveçla: - theksoi se shkollat i raportojnë Drejtorisë së Arsimit dhe ju jeni personi përgjegjës për këtë sepse hierarkia përfundon tek ju.

Samir Shahini: - tha se organi i ankesave, i Komisionit disiplinor është i pavarur dhe nuk janë në menaxhimin tim.

Gëzim Sveçla: - tha se nuk pyeta për komisionin, por për natyrën e shkeljes, a kanë marrë hapa tjerë, a janë dërguar në institucione tjera, a ka rrezik që vepra mund të ndërtojë vepër penale, pra cilat janë veprimet që i ke marrë si DKA?

Samir Shahini: - tha se DKA-ja merr vendim në organizim administrativ edhe të pjesës së programit punës në koordinim me ministrinë përkatëse dhe kryetar në kabinetin, ndërsa sa i përket anës penale ose të gjeturave të komisionit, është detyrë e komisionit të dërgojë tutje. Ai tha se ne kemi pasur për detyrë që aty të vendosim sa më shpejt menaxhmentin e ri, të funksionalizohet KDSH-ja, të mbikëqyrim vendosjen e tyre dhe të japim propozimet.

Gëzim Sveçla: - pyeti se kush i mbron ata fëmijë dhe a është shkelje e rëndë ashtu siç kemi dëgjuar?

Samir Shahini: - tha se fëmijët i mbron mësimdhënësi, drejtori, Drejtoria e Arsimit dhe Kryetari i komunës, ndërsa nëse e keni fjalën për pjesën e ngacmimeve seksuale, në raportin të cilin e kemi pranuar nga Komisioni disiplinor askund nuk përmendet një diçka e tillë.

Gëzim Sveçla: - tha pse unë duhet t'i drejtohem Komisionit disiplinor kur Komuna e Prishtinës e ka një drejtor të arsimit dhe t'i duhesh me i raportu Kuvendit? Sveçla theksoi se Komiteti për Politikë dhe Financa është organi më i lartë i Kuvendit, ku diskutohet para seancës së Kuvendit për të gjitha problemet e Komunës së Prishtinës, prandaj unë si anëtar i këtij komitetit, po të kërkoj me ma dërgu raportin e komisionit për krejt se çfarë ka ndodh. Ai tha se nuk është hera e parë që po ndodhin këso raste të tilla, situata është alarmante me shkollat e Prishtinës, çfarë veprime jeni duke i marr me i mbrojt këta fëmijë?

Samir Shahini: - tha se unë këtu jam me raportu atë që mua më takon me raportu, ndërsa për pjesën tjetër është organi i pavarur. Shahini tha se ju mundeni me kërkë që unë si drejtor me kërkë nga komisioni raportin që ta ndajmë juve si leje fillimisht, sepse është diçka e cila mund të ketë precedent të trajtohet nga drejtësia dhe të cilat i ka komisioni në kompetencë t'i ndajë. Drejtori tha se në asnjë moment nuk deklarova që ju nuk keni të drejtë me i marr, vetëm se duhet t'i kërkoni nga ata dhe jo nga unë.

Gëzim Sveçla: - tha se ju jeni drejtor i zgjedhur këtu prandaj duhesh t'i përmbahesh detyrës dhe t'u përgjigjesh pyetjeve të cilat ne si anëtarë të komitetit kemi të drejtën t'i parashtrojmë. Sveçla tha se kërkoi që kjo të jetë pjesë e hartimit të ekstraktit të mbledhjes, se si një Drejtori i Arsimit në Komunën e Prishtinës po heziton të tregojë se çfarë ka ndodh, cilat janë shkeljet apo veprat që një drejtor në një shkollë në kryeqytet i ka kryer dhe është ulur në pozitë, dhe kur ne po i kërkojmë raportin, drejtori thotë se duhet t'ju drejtoheni komisionit të pavarur disiplinor. Ai tha nuk është e nevojshme që ne t'i mësojmë se kush janë komisionet në shkolla apo të kërkojmë përgjegjësi nga ta se çfarë po ndodh, kur ju jeni përgjegjësi kryesor dhe drejtor i arsimit në Komunën e Prishtinës.

Samir Shahini: - tha se ne si drejtori kemi pas kërkesa të shumta nga media të ndryshme për të raportuar apo deklaruar për këto çështje, prandaj po ju tregoj edhe disa përgjigje rreth kësaj çështjeje të cilat i kemi ndarë edhe me mediat si p.sh., mosrespektimi i transparencës institucionale ku është konstatuar se ka pas keqmenaxhim të ofertave për uniforma, për dhënien në shfrytëzim të bufësë edhe aktivitete tjera që nuk janë publiku në faqen zyrtare të shkollës, por vetëm në tabelë të njoftimeve që përbën shkeljen, duke mos përmbush kriteret e transparencës dhe njoftimit të opinionit publik. Shahini më tej theksoi edhe lejin e aktiviteteve jashtkurrikulare pa autorizim institucional, duke pas për më tepër ndalesë, sikur ka qenë fjala për ekskursionin në Brezovicë, të datës 25 shkurt të këtij viti, pa autorizim të Drejtorisë së Arsimit, përkundër edhe ndalesës së qartë e cila është dhënë më datë 24.2.2015. Pastaj manipulim të të dhënave në ditar, mungesë të raportimit dhe dokumentimit për asgjësim të inventarit pas renovimeve të cilat i ka pasur shkolla. Ai tha se këto janë disa nga pikat, por prapë po e theksoj se raportin e detajuar duhet ta kërkoni nga Komisioni disiplinor, i cili është organ i pavarur i komunës.

Bahri Gashi: - pyeti drejtorin se a ka pasur ndonjë hetim nga Policia e Kosovës apo është përmbyll vetëm në Komisionin disiplinor të komunës?

Samir Shahini: - tha se deri tash sa kam informata nuk kemi ndonjë përfshirje të policisë në këtë rast. Shahini tha se edhe unë i kam rekomanduar komisionit që rasti të vazhdohet me hetime të plota nga Policia e Kosovës, por ky është mendimi personal dhe besoj se duhet trajtuar nga organet e drejtësisë për të përacaktuar a është apo jo rast penal.

Bahri Gashi: - tha unë të kisha rekomanduar me ju propozuar komisionit, me i thirr organet e drejtësisë sepse duke u bazuar në ato çfarë ke folur dhe nga ajo se ka pasur një renovim mjaft të madh në shkollë, besoj se ka nevojë për një hetim më të hollësishëm.

Nora Kelmendi: - tha se ekzistojnë procedurat administrative dhe drejtori i shkollës është dërguar në Komision disiplinor me kërkesë të drejtorit të arsimit. Ajo tha se Komisioni disiplinor funksionon në mënyrë të pavarur dhe pasi ka shqyrtuar rastin ka dhënë rekomandimet dhe pastaj është vepruar duke ulur drejtorin në pozitë. Kelmendi tha se ne si anëtarë të Komitetit për Politikë

dhe Financa, apo anëtarë të Kuvendit kërkojmë nga ju si drejtor i arsimit, të gjithë dokumentacionin si ka shkuar e gjithë procedura që nga inicimi i rastit deri në përfundim.

9. Propozim-vendim për ndërrim të destinimit nga banim individual në institucion arsimor privat

Arbër Sadiki: - tha se bëhet fjalë për një kërkesë të një pjese të Planit Rregullues “Mati 3” një sipërfaqe saktësisht gjashtë mijë metra katrorë, e cila për momentin ka destinim banim individual dhe kërkesa është që ajo të kthehet për destinim edukativ. Sadiku tha se për shkak të dinamikeve të ndryshimit të karrikulave sidomos në drejtim të shkollave digjitale dhe duke u nisur nga ajo se investitori nuk ka bërë kërkesë për të marrë tokën publike apo subvencione për këtë, por kërkesa është që tokën që posedon ta kthejë në destinim edukativ.

Gëzim Sveçla: - tha se propozimi nuk ka certifikatë pronësore dhe a është miratuar ndonjë vendim i tillë në Kuvendin komunal, sepse nëse fillojmë që Kuvendi të ndërrojë destinimin e parcelave, objekteve ose çkado qofshin ato, apo i bjen që këto lokalet në katin e parë që janë në krejt Prishtinën, që dikur kanë qenë banesa, a duhet të sjellen në Kuvend për t’u ndryshuar destinimin? Sveçla tha se a mundesh me ndërruar destinimin në Kuvend veç për një parcelë, pa e ndërruar, pa e hap pronën?

Arbër Sadik: - deklaroi se kërkesa për ridestitim të një pjese, nuk mund të barazohet me kërkesa tjera të ngjashme, pasi kjo kërkon një rishikim të Planit Rregullativ “Mati 3”. Sadiku theksoi rëndësinë e hapësirës për arsimin privat, duke vlerësuar kontributin publik të tyre. Ai u ndal në dallimin midis kësaj kërkesë dhe ridestitimeve brenda njërive banesore, të cilat sipas tij janë problematike dhe nuk mund të barazohen, pasi ato bëhen brenda tërësisë së ndërtesës dhe ndikojnë në ndryshimin e përdorimit të funksionit të ndërtesës. Arbër Sadiki shtoi se gjatë kohës që ka qenë drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, nuk ka aprovuar ridestitime të ndërtesave të banimit në ndërtesa për shërbime tregtare, për shkak të kërkesave për parkingje dhe ndikimit në zonat e zhvillimit urban. Ai konsideron se vendosja e një shkolle brenda një zone të destinuar për banim nuk e dëmton zonën, përkundrazi e pasuron atë, pasi prania e një shkolle është e dëshirueshme për banorët e lagjes. Sadiki theksoi se të gjithë parametrat urbanistikë, si koeficientët e ndërtimit dhe hapësirat e lira, janë respektuar dhe në disa raste janë më të favorshme se ato që parashikon zona aktuale, ndaj nuk sheh ndonjë problem në këtë ridestitim.

Gëzim Sveçla: - tha se nuk kemi dyshim në pjesën e rëndësisë dhe sa e nevojshme është hapja e shkollës, por problemi ekziston në aspektin ligjor, se a po krijojmë një precedent që çdo individ i çfarëdo lagje të caktuar të bëjë kërkesë për ndryshimin nga banimi individual në diçka tjetër.

Arbër Sadiki: - sqaron se kjo situatë është shumë e ngjashme me rastet kur është përcaktuar lokacioni për ndërtesa të arsimit apo të shëndetësisë, ku shpeshherë pjesa përkatëse ka qenë hapësirë private dhe më pas është bërë shpronësimi. Sadiki shton se hapja e plotë e planit rregullues zakonisht ndodh kur ndërhyrjet janë të mëdha dhe kanë ndikim të gjerë në gjithë lagjen. Në rastin konkret, ai beson se ndryshimet që mund të bëhen nga urbanizmi apo planifikimi janë të kufizuara dhe çdo ndryshim i madh duhet të kalojë për miratim në Kuvend. Ai theksoi se planet miratohen nga Kuvendi dhe se nuk është në rregull që një drejtori të bëjë ndryshime të tilla vetëm me

kompetencat e veta. Sadiki argumentoi se procesi që po ndjekin është transparent dhe bazohet në vendimmarrjen e institucioneve kompetente, duke nënvizuar se për këtë çështje kompetent është Kuvendi komunal.

Gëzim Sveçla: - tha se nuk mora përgjigje në pyetjen, ky Kuvend a ka marrë ndonjëherë vendim të tillë. Ai tha se unë e di që me shtimin e numrit të banorëve në një lagje të caktuar është rritur nevoja për një objekt shkollor, qoftë ai privat apo publik. Sveçla tha se a jemi duke hapur rrugë që kushdo që ka një ide për një projekt të caktuar, të bëjë kërkesë për ndryshimin e destinimit në Kuvend, a jemi duke bërë shkelje ne si Kuvend?

Arbër Sadiki: - tha se ky propozim është i njëjtë me vendimet tjera të votuara nga ju në lidhje me pronat dhe i vetmi dallim është që këtu bëhet fjalë për një instucion të arsimit privat. Sadiki tha se ne e kemi pranuar kërkesën, e kemi hartuar Propozim-vendimin tash është në dorën tuaj për ta mbështetur apo jo të njëjtin.

Bahri Gashi: - pyeti nëse duhet është konsultuar me banorët e komplekseve aty afër rreth këtij ndryshimi, a ka ndonjë dëm apo diçka të ngjashme? Ai tha se ju si drejtor shumë mirë që e keni sjellë në Kuvend, por është përgjegjësi politike e jona si asamble ta votojmë apo jo. Gashi shprehu shqetësimet duke kërkuar më shumë informata, çfarë shkolle mund të jetë planifikuar, a i plotëson nevojat e komunitetit, pastaj pyeti për numrin e nxënësve sa është paraparë, biznesplanin dhe planin arsimor të projektit?

Arbër Sadiki: - shpjegoi se materiali që është ndarë me anëtarët përfshin vetëm informacionin bazik të lokacionit dhe planin rregullues. Në seancën e Kuvendit do të prezantohen të gjitha detajet e ndryshimeve që do të bëhen në plan. Ai theksoi se nuk bëhet fjalë për ndryshime rrugësh apo elementësh tjerë që prekin planin në thelb, sepse në atë rast do të duhej të rishqyrtohej i gjithë plani nga fillimi. Ndryshimi përfshin vetëm mbajtjen e infrastrukturës ekzistuese dhe modifikimin e parcelës brenda posedimit të aplikuesit. Sa i përket shkollës, bëhet fjalë për një shkollë digjitale e akredituar dhe aktive prej disa vitesh, e cila ka treguar rezultate pozitive në punën e saj, bazuar në vëzhgimet dhe dëgjimet në komunitet. Për seancën e Kuvendit, do të jenë në dispozicion edhe detaje teknike më të thelluara, megjithatë ato janë voluminoze dhe mund të jenë të vështira për t'u kuptuar pa një prezantim të detajuar për shkak të natyrës teknike dhe profilit të ndryshëm të pjesëmarrësve.

Bahri Gashi: - theksoi rëndësinë e njohjes së detajeve teknike dhe të planit strategjik të shkollës në fjalë. Ai kërkoi informacion më të qartë për emrin e shkollës, planin pesëvjeçar apo dhjetëvjeçar dhe sigurinë që destinacioni i shkollës nuk do të ndryshojë në të ardhmen, për shembull, që shkolla të mos kthehet në ndonjë hotel apo qendër tjetër. Ai nënvizoi nevojën për të ditur historikun, përvojën, numrin e nxënësve, stafit dhe ndikimin që shkolla ka në rrethin ku funksionon, si dhe në qytetin e Prishtinës në përgjithësi. Bahriu kërkoi që të gjitha këto materiale dhe plani i zhvillimit të shkollës të bëhen të qasshme për anëtarët, që të mund të marrin një vendim të informuar dhe për të parë ndikimet afatgjata në komunitet dhe qytet. Ai theksoi nevojën për një plan të qartë dhe të mirëmenadur, duke sugjeruar se pa këtë, ekziston rreziku që në mandatin tjetër të propozohet ndryshimi i funksionit të shkollës. Në fund, ai kërkoi që materialet e plani t'u dorëzohen anëtarëve sa më parë për përgatitje dhe diskutim.

Arbër Sadiki: - tha se do të mundohem që deri në seancë t'i siguroj të gjitha informacionet të cilat i kërkon ju dhe t'i sjell ato për mbledhje sepse këto informata janë në interes për të gjithë ne.

Leutrim Retkoceri: - kërkoi që drejtori të sjellë pëlqimin e zyrës ligjore për pikat nëntë dhe dhjetë të rendit të ditës, që të mund të vazhdohet trajtimi në Kuvend. Retkoceri ngriti shqetësimin për

vazhdimin e seancave pa kuorum, duke nënvizuar se ligji e lejon vetëm kryesuesin të nisë ose mbyllë seancat dhe në mungesë të kuoromit punimet nuk duhet të vazhdojnë, përfshirë ndezjen e mikrofonave për deklarime. Ai theksoi se mosrespektimi i këtyre rregullave përbën keqpërdorim të kompetencave ligjore dhe mund të ketë pasoja në nivele tjera. Megjithatë, ai shprehi keqardhje që duhet të ngrisë këtë çështje ndaj personave që janë në shërbim publik dhe punojnë për pagë, duke theksuar se ligji duhet të respektohet nga të gjithë pa përjashtim. Në fund, ai kërkoi që të jepet përgjigje në lidhje me pëlqimin ligjor, përndryshe do të veprojë në organet tjera.

Nora Kelmendi: - pyeti drejtorin se a ka marr përgjigje nga zyra ligjore për propozim-vendimin, sepse unë i kam lexuar dispozitat ligjore, por asnjë nuk qëndron dhe nëse e keni, të na përcjellni edhe neve për ta analizuar.

Arbër Sadiki: - tha se pjesa ligjore e vendimit është përgatitur pikërisht nga zyra ligjore, por prapë do të konsultohemi me ta dhe do mundohemi t'ju sqarojmë për këto shqetësime.

Gëzim Sveçla: - shprehu qëndrimin e tij kundër ndryshimit të destinimit të pronave në Kuvend, duke theksuar se një veprim i tillë mund të dëmtojë planifikimin urbanistik të qytetit. Ai theksoi se nuk kanë ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë ndryshime të tilla dhe se propozimet për ndërrim destinimi nuk kanë ardhur nga Drejtoria e Urbanizmit, por nga individë që më pas i kanë drejtuar kërkesat në Kuvend. Sveçla shpjegoi shqetësimin se nëse lejohet kjo praktikë, në çdo lagje do të ketë kërkesa të vazhdueshme për ndryshime destinimi, duke shkaktuar rrëmujë urbanistike. Ai mbështet fuqimisht investimet për hapjen e shkollave dhe i quan të domosdoshme, por kërkon që këto të realizohen në mënyrë të planifikuar dhe pa dëmtuar strukturën urbanistike të qytetit. Për më tepër, thotë se mund të nevojitet që toka komunale të vihet në dispozicion për këto investime në vende të përshtatshme dhe të paracaktuara për shkolla, duke shmangur ndryshimet ad-hoc të destinimeve që mund të krijojnë precedent negativ.

Bahri Gashi: - falënderon për mundësinë e diskutimit dhe theksoi se, pavarësisht fjalëve në mikrofon, ata janë seriozë dhe të përkushtuar ndaj përgjegjësisë së tyre si përfaqësues politikë të qytetarëve. Ai shpreh respekt për kolegët dhe pajtohet me Gëzim Sveçlën që Drejtoria e Urbanizmit duhet të ketë rol udhëheqës dhe të mos marrë vendime të njëanshme që ndikojnë në jetën e qytetarëve, sidomos të lagjeve. Gashi pranon se nuk janë ekspertë urbanistë, por besojnë në informacionin dhe udhëzimet e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit. Ai kërkoi më shumë transparencë për shkollën në fjalë dhe investimin e saj, pasi kjo ndikon drejtpërdrejt tek ata. Gashi falënderoi drejtorin për mundësinë e debatit dhe nxiti që ide të ngjashme të trajtohen më shpesh në asamblë. Ai theksoi se kërkesat për ndryshime destinimi vijnë nga qytetarët dhe duhet të merren në konsideratë. Për më tepër, thekson se hapja e kateve të para pa leje në Prishtinë është ndaluar kohët e fundit dhe ka një vetëdijësim të përmirësuar për respektimin e ligjit urbanistik. Ai pranon se ka raste të ndryshimeve të destinimeve, përfshirë shkolla dhe biznese, por me kërkesë dhe proces

të rregullt. Në fund, Bahri Gashi shpreh mbështetjen e tij për propozimin e drejtorit, duke kërkuar vetëm më shumë informacion rreth mënyrës së realizimit të tij.

Jeta Rafuna: - shpreh shqetësimin lidhur me krijimin e precedentëve për ndryshimin e destinacionit të tokave në lagje të ndryshme, duke theksuar se kjo mund të sjellë probleme të shumta, jo vetëm për shkolla, por edhe për xhami e objekte tjera. Ajo tregon një rast nga viti i kaluar kur një person nga fshati i saj erdhi për të mbledhur nënshkrime për ndryshimin e destinacionit, por banorët nuk ishin dakord. Jeta gjithashtu kërkon informacione më të qarta për shkollën në fjalë, pasi as ajo dhe kolegu i saj Bahriu nuk e dinë saktësisht se çfarë shkollë është, dhe sugjeron që informatat të dërgohen me email për t'i komunikuar më mirë asamblistëve. Ajo përmend edhe nevojën për të marrë pëlqimin e banorëve para se të votohet.

Arbër Sadiki: - u shpreh se shumica e shkollave private punojnë në ndërtesa pa leje, veçanërisht në lagjet si Dardani dhe Lakërishte, duke theksuar se kjo është një situatë e njohur për të gjithë. Ai foli për nevojën e krijimit të një modeli dinamik për menaxhimin e ndryshimeve në destinacionet e tokave, ku vendimet të merren në asamble dhe të diskutohen rast pas rasti, në mënyrë që të mund të lejohet vetëm kur ka kuptim dhe përfitim për shoqërinë. Ai theksoi që vendimet aktuale janë shumë të ngadalta për situata që mund të zgjidhen më shpejt. Gjithashtu përmendi se problemet nuk janë vetëm me shkollat, por edhe me xhamitë dhe kishat që kërkojnë përcaktime të lokacioneve. Sadiki deklaroi se shkolla digjitale për të cilën po flitet është e licencuar dhe nuk është klandestine dhe se do të sigurojë të gjitha materialet e nevojshme për asamblenë për t'i dhënë mundësi të marrin vendimin e duhur.

Bahri Gashi: - i drejtohet drejtorit duke i kërkuar që në të ardhmen të përgatitet më mirë për diskutimet në asamble, pasi pyetjet nga anëtarët mund të jenë të shumta dhe të zgjatura. Ai theksoi se edhe pse ndonjëherë pyetjet e tyre mund të mos kenë kuptim teknik për profesionistët, ato janë të rëndësishme për transparencë. Bahriu kërkoi që të bëhet e qartë kush është pronari dhe themeluesi i shkollës në fjalë, pasi ekziston mundësia që një subjekt tjetër ta blejë dhe të ndryshojë qëllimin apo vlerat e saj. Ai përmendi edhe raste të objekteve të kultit që janë shndërruar pa leje në lagje të ndryshme si "Sofalia", duke i bërë thirrje planifikuesve që në planet urbanistike të parashikojnë hapësira të lira për nevojat e banorëve – qoftë për shkolla, xhami, kisha apo objekte tjera publike. Ai e përkrah kërkesën për shkollën digjitale, por kërkon të ketë më shumë dokumentacion dhe transparencë mbi pronësinë.

10. Propozim-vendim për lënie në dëgjim publik të PRRH "Mati 1", blloku A 11

Arbër Sadik: - sqaroi se është duke u shqyrtuar një plan rregullues i hollësishëm për lagjen "Mati 1", një proces që ka nisur prej disa muajsh, por për shkak të dinamikave në Kuvend, nuk është arritur të hapet diskutimi publik deri më tani. Ai theksoi se bëhet fjalë për një hapësirë të madhe private pranë "Rrugës C" në drejtim të Matiçanit, e cila prej 15 vjetësh ka pasur destinim për shkollë dhe çerdhe, por nuk është realizuar as ndërtimi publik, as privat, për shkak të vështirësive në shpronësim dhe të drejtën e kufizuar të ndërtimit për pronarët. Plani i ri synon rishikimin e parametrave, duke ruajtur afërsisht të njëjtat përmasa për hapësirat publike, por duke lejuar ndërtim në një pjesë të pronës, në mënyrë që pjesa tjetër të shpronësohet plotësisht për shkollë dhe çerdhe. Ai theksoi se kjo është një zgjidhje praktike, që mundëson zhvillimin urban dhe njëherësh shërbimet publike që i duhen qytetit. Sadiki tha se ky është edhe një vullnet politik për të marrë

vendime të balancuara dhe se për çdo ndryshim, i vogël apo i madh në plane, është e nevojshme që të diskutohet e miratohet në Kuvend.

Gëzim Sveçla: - tha se kjo është rruga që duhet me ndjek për revidim të planit, pa marr parasysh që po flasim për hapësirë shumë më të vogël. Sveçla pyeti drejtorin, se kur është bërë ky Plan rregullativ, a ka të drejtë ligjore tash me u hap ky plan edhe nëse nuk bëhet me revidim, a mund të bëhet me miratimin e PZHK-së ose me hartë zonale.

Arbër Sadiki: - shpjegoi se që nga viti 2013 ka ekzistuar bashkëpunimi mes Ministrisë së Planifikimit dhe drejtorive të urbanizmit në nivel komunal për çështjet e planifikimit hapësinor. Ai theksoi se megjithëse është dashur që të gjitha komunat të pajisen me Plane Zhvillimore Komunale dhe harta zonale, kjo nuk ka ndodhur në praktikë, ndaj proceset aktuale ndjekin modele të mëparshme. Sadiki argumenton se vendime të tilla janë marrë edhe më parë, por në këtë rast dallimi qëndron në natyrën e investimit – privat, por me funksion publik. Ai theksoi se duhet guxim dhe vullnet politik për ta trajtuar një shkollë private si investim me interes publik dhe propozoi që në vendimin urbanistik të përfshihen kushte ligjore që garantojnë funksionimin e objektit si shkollë për një periudhë të caktuar, për të shmangur devijime të mëvonshme në përdorim.

Bahri Gashi: - sqaron se mbikëqyrja e një investimi nuk duhet të quhet kushtëzim, por një mënyrë për të ndihmuar dhe orientuar zhvillimin. Ai kritikon mënyrën se si është trajtuar projekti i ndërtimit të një shkolle dhe ndërtesave banesore në një parcelë që prej vitesh ka mbetur e pazhvilluar. Gashi ngre shqetësime për arsyeshmërinë e ndërtimit të një shkolle në atë zonë, duke përmendur se aty ndodhen tashmë disa shkolla të afërta, përfshirë edhe shkollën "Pavarësia", e cila është zgjeruar me aneks. Ai theksoi se planifikimi duhet të bazohet në të dhëna reale për numrin e nxënësve dhe nevojat e komunitetit, në mënyrë që të mos ndërtohet një shkollë që mbetet pa funksion dhe pa nxënës.

Arbër Sadiki: - sqaron se Drejtoria e Planifikimit bazohet në të dhënat që merr nga Drejtoria e Arsimit për të planifikuar nevojat për shkolla në qytet. Ai theksoi se lagjja në fjalë është ndër më të dendurat dhe ka një numër të madh fëmijësh që kanë nevojë për shkollë. Megjithëse ndërtimi i menjëhershëm i shkollës mund të mos jetë i mundur, është pozitive që parcela në fjalë do të kthehet në pronë komunale dhe në të ardhmen mund të përdoret për interesa publike, nëse planifikimi i mëtejshëm tregon mungesë të nevojës për shkollë në atë zonë. Sadiki gjithashtu sqaroi se shpronësimi i tokës në fjalë është i pamundur në mënyrë tjetër, pasi një pjesë e madhe e saj (rreth 50%) do të përdoret për qëllime publike. Ai përmendi se ndryshimet në planifikim nuk do të rrisin dendësinë e ndërtimit, por do të shtojnë etazhet dhe do të zvogëlojnë hapësirat e shputës, duke lënë më shumë hapësirë për infrastrukturë publike ose ndërtesa publike.

Bahri Gashi: - pyeti nëse asambleja komunale ka kompetencë për të vendosur që një pjesë e tokës, e cila i takon një investitori privat, të mos përdoret për ndërtimin e shkollës, por të mbetet e hapur sipas planeve të miratuara, duke shmangur kështu "gozhdimin" e qëllimit shkollor për atë parcelë. Ai shprehu shqetësimin se në zonën përreth ka shumë shkolla dhe se ndërtimi i një tjetër mund të ndikojë negativisht tek shkolla ekzistuese "Pavarësia". Gashi vëren se nëse toka i kalon komunës, situata mund të ndryshojë. Gjithashtu, ai ngre dyshime lidhur me pronësinë e disa objekteve dhe hapësirave publike në Prishtinë, duke përmendur se parkingjet dhe tokat përreth banesave shpesh janë ende në pronësi private, duke vështirësuar përdorimin e tyre si hapësira publike.

Arbër Sadiki: - sqaroi se që nga viti 2014, çdo leje ndërtimore e lëshuar në Prishtinë ka përfshirë unifikimin e parcelave që marrin pjesë në ndërtim. Sipërfaqet e tokës që hyjnë në koeficientin e ndërtimit kalojnë automatikisht në bashkëpronësi të të gjithë blerësve të njësive banesore. Sadiki thekson se pavarësisht perceptimeve personale të ish-pronarëve, tokat e përfshira në lejet ndërtimore nuk mund të trajtohen më si prona private të veçuara, pasi ato janë integruar ligjërisht në bashkëpronësi si pjesë e projektit ndërtimor.

Gëzim Sveçla: - pyeti drejtorin, pasi kemi pritur që 15 vite, a mundemi me e shty miratimin e kësaj pike deri në muajin dhjetor?

Arbër Sadiki: - tha se unë mundohem në atë mënyrë që çdoherë të punojmë diçka, tash në dhjetor apo edhe pas pesë vitesh.

Bahri Gashi: - tha se ty drejtor të falënderojmë për punën dhe të kërkojmë falje sepse jo çdoherë punët kryhen ashtu si mendon. Gashi tha se personalisht mendoj që jemi shumë vonë edhe ju si drejtori, sepse punët duhen të kryhen sa më parë pasi që ata banorë të cilët kanë tokë aty kanë mbetur shumë keq.

11. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka ndonjë kërkesë për diskutim.

Mbledhja mbaroi në orën 12:00.

Procesmbajtësi
Arton Brahim

Kryesues i Komitetit
Fehmi Klupina

